# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.legjislacionishqiptar.gov.al**
**www.qpz.gov.al**

| **Nr.118** | **25 korrik** | **2008** |


**P Ë R M B A J T J A**


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret nr.5814 datë 16.7.2008 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare ...................................... | 5185 |
| Vendim i KM nr.1016, datë 2.7.2008 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Dragostunjë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ...................................... | 5186 |
| Vendim i KM nr.1017, datë 2.7.2008 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shushicë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ...................................... | 5186 |
| Vendim i KM nr.1018, datë 2.7.2008 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Mallakastër”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ...................................... | 5187 |
| Vendim i KM nr.1019, datë 2.7.2008 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe spitalin ushtarak qendror universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar ...................................... | 5187 |
| Vendim i KM nr.1020, datë 2.7.2008 | Për disa ndryshime në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar ...................................... | 5199 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.1022, datë 9.7.2008 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.161, datë 11.4.1994 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore" …………………………… | 5210 |
| Vendim i KM nr.1025, datë 9.7.2008 | Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen …………………………………… | 5212 |
| Vendim i KM nr.1026, datë 9.7.2008 | Për caktimin e dietës ditore të ushtarakëve shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, në kuadër të operacionit ushtarak "EUFOR TCHAD/RCA", të Bashkimit Europian ………………………….. | 5217 |
| Vendim i KM nr.1027, datë 9.7.2008 | Për një ndryshim në vendimin nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisionit të posaçëm, për dhënien e licencave profesionale", të ndryshuar …………… | 5217 |
| Vendim i KM nr.1028, datë 9.7.2008 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Dishnicë, të qarkut të Gjirokastrës ………….. | 5218 |
| Vendim i KM nr.1029, datë 9.7.2008 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gruemirë, të qarkut të Shkodrës ……………. | 5222 |
| Vendim i KM nr.1030, datë 9.7.2008 | Për një ndryshim në vendimin nr.411, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Sarandë, të qarkut të Vlorës", dhe për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Sarandë, të qarkut të Vlorës ……… | 5226 |
| Vendim i KM nr.1035, datë 9.7.2008 | Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të transportit …………….. | 5228 |
| Vendim i KM nr.1070, datë 23.7.2008 | Për miratimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërdarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve …………………………… | 5229 |
| Kërkesë e MF | Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Vermosh………………………………………………………… | 5229 |

**DEKRET**
**Nr.5814, datë 16.7.2008**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Oksana Pavllo Kostyuk (Lisova)
2. Artan Selim Selimi
3. Niman Arif Halilaj (Shala)
4. Kinora Reshad Korbi (Shala)
5. Maria Grazia Pietro Amore
6. Alvina Ilie Talchig (Dulla)
7. Immanuel Max Vögeli
8. Daniel Immanuel Max Vögeli
9. Ruth Immanuel Max Vögeli
10. Natanja Immanuel Max Vögeli
11. Jonatan Immanuel Max Vögeli
12. Claudia Judith Christoph Vögeli (Arnold)
13. Sami Rahman Qunaj
14. Xhelil Sherafet Bajrami
15. Dolly Mohamad Hello (Hallaci)
16. Nadine Astrid Peter Gaxholli (Liechti)
17. Patricia Esther Garcia Britos
18. Adnan Niyazi Sevilen
19. Angelo Antonio Zito
20. Ana Ion Zyka (Snegur)
21. Natalia Vladimir Ruko (Larionova)
22. Skënder Adem Muja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Bamir Topi**

**VENDIM**
**Nr.1016, datë 2.7.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME**

**KONCESION TË HIDROCENTRALIT "DRAGOSTUNJË", DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Dragostunjë", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "GURRA" , sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Dragostunjë", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1017, datë 2.7.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT SHUSHICË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shushicë, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Denyl" sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shushicë, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1018, datë 2.7.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME**

**KONCESION TË HIDROCENTRALIT "MALLAKASTËR", DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Mallakastër", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "ALBADI", sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Mallakastër", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1019, datë 2.7.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Lidhja nr.1 (krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 e 1.10) zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2, vlera "…9 000 lekë në muaj…" zëvendësohet me "….11 000 lekë në muaj…".

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Punonjësit me arsim të lartë në sistemin shëndetësor, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes nr.1 (krerët 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 e 1.10) përfitojnë shtesë në kualifikim grade apo titull shkencor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit janë:

a) Kjo shtesë jepet kur përputhet kualifikimi, grada apo titulli shkencor me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Ministria e Shëndetësisë.

b) Kur punonjësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, siaps lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin

organik.

c) Kur punonjësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit, e përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, që ka.

Në çdo rast, sa më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli që ka, punonjësi përfiton shtesë vetëm për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, sipas përcaktimit të shkronjave "a", b" e "c", dhe jo shumën e tyre.

Për aplikimin e kësaj shtese zbatohen rregullat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.".

2. Efektet financiare për vitin 2008, për paga e sigurimeve shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të këtij viti, për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1 (KREU 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK NR.1, NR.2 TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE "SHEFQET NDROQI" TIRANË, KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË, SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR TIRANË

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor -QSU "Nënë Tereza"Tiranë, | 11000 | 2% | 0 | 86 500 | | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | -Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Garaldinë” Tiranë, Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë, - Spitali i Sëmundjeve të Mushkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë | | | | | | |
| 2 | Drejtor -Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë | 11 000 | 2% | 0 | 58 300 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Zëvendësdrejtor | 11 000 | 2% | 0 | 49 500 | | Nga…deri…lekë |
| 4 | Shef shërbimi, Shef i sektorit biomedikal | 11 000 | 2% | 0 | 41 000 | | Nga…deri…lekë |
| 5 | Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj). Shef i Qendrës së Gruas | 11 000 | 2% | 0 | 38 500 | | Nga…deri…lekë |
| 6 | Shef reparti/klinike reanimacioni | 11 000 | 2% | 0 | 38 500 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 7 | Shef reparti/klinike psikiatrie | 11 000 | 2% | 0 | 38 500 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 8 | Shef i laboratorit klinik biokimik, Shef reparti kimioterapi, Shef laboratori, Shef i qendrës së diagnozës molekulare | 11000 | 2% | 0 | 38 500 | 2 200 | Nga…deri…lekë |
| 9 | Shef reparti rrezatimi, Shef reparti i kyrisë | 11 000 | 2% | 0 | 38 500 | 4 600 | Nga…deri…lekë |
| 10 | Shef kabineti, Shef i qendrës së protezimit, Inxhinier biomedikal | 11 000 | 2% | 0 | 36 000 | | Nga…deri…lekë |
| 11 | Shef sektori, Shef farmacie në solucionet e injektueshme, Biokimist në solucionet e injektueshme, Inxhinier i sistemeve të ngrohjes, | 11 000 | 2% | 0 | 30 000 | | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Inxhinier hemodialize | | | | | | |
| 12 | Mjek,<br>stomatolog,<br>Biolog, kimist, fizikan në preparatori,<br>Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog,<br>Përgjegjës qendre DDD,<br>Specialist fizkulture (fizioterapi neurologji),<br>Kryellogaritar,<br>Revizor | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | | Nga…deri…lekë |
| 13 | Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale),<br>Mjek onkolog,<br>Mjek fizioterapevt,<br>Mjek obsetër gjinekolog,<br>Mjek pneumoftiziatër | 11000 | 2% | 0 | 26 500 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 14 | Mjek radiolog,<br>Toksikolog, kimist, në laboratorin toksikologjik,<br>Kimist në laboratorin bikimik,<br>Fizikant në laboratorin biokimik,<br>Biolog në laboratorin biokimik | 11000 | 2% | 0 | 26 500 | 1 600 | Nga…deri…lekë |
| 15 | Mjek kimioterapevt,<br>Mjek hematolog,<br>Mjek infeksionist,<br>Mjek në pranim urgjence,<br>Mjek në njësinë nozokomiale,<br>Mjek laboratori,<br>Mjek histopatolog,<br>Mjek në shërbimin e gjakut | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | 2 000 | Nga…deri…lekë |
| 16 | Mjek në inspektoratin sanitar,<br>Inspektor sanitar,<br>Epidemiolog,<br>Farmacist | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | 2 500 | Nga…deri…lekë |
| 17 | Farmacist në laboratorin toksikologjik, | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | 2 800 | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mjek laboratori izotopik,<br>Fizikant,<br>Kimist,<br>Kimist laboratori izotopik,<br>Mjek në hemodinamikë,<br>Fizikant në higjienë dhe epidemiologji,<br>Inxhinier kimist në shërbimin e higjienës në SUQU,<br>Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike në SUQU | | | | | | |
| 18 | Mjek anatomopatolog,<br>Mjek anestezist, reanimator,<br>Mjek në pavionin e rrezatimit,<br>Mjek në pavionin e kyrisë,<br>Specialist në qendrën e diagnozës molekulare,<br>Fizikant kobalti | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | 3 700 | Nga…deri…lekë |
| 19 | Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri | 11 000 | 2% | 0 | 26 500 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 20 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | 0 | 25 000 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE, SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor dhe kryeinspektor sanitar,<br>Drejtor ekzekutiv | 11 000 | 2% | | 58 300 | 9 000 | Nga…deri…lekë |
| 2 | Zëvendësdrejtor | 11 000 | 2% | | 41 000 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Shef shërbimi i | 11 000 | 2% | | 30 000 | | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kujdesit parësor,<br>Shef shërbmi urgjence,<br>Shef shërbimi i mjekësisë familjare | | | | | | |
| 4 | Shef shërbimi i higjienës,<br>Shef shërbimi i epidemiologjisë | 11 000 | 2% | | 30 000 | 9 000 | Nga…deri…lekë |
| 5 | Shef shërbimi stomatologjik | 11 000 | 2% | | 30 000 | 3 300 | Nga…deri…lekë |
| 6 | Shef sektori,<br>Shef reparti,<br>Shef kabineti,<br>Shef/përgjegjës laboratori,<br>Përgjegjës dispancerie | 11 000 | 2% | | 25 000 | | Nga…deri…lekë |
| 7 | Specialist i lartë në higjienë,<br>Specialist i lartë në epidemiologji | 11 000 | 2% | | 25 000 | 7 000 | Nga…deri…lekë |
| 8 | Epidemiolog,<br>Higjienist | 11 000 | 2% | | 25 000 | 8 000 | Nga…deri…lekë |
| 9 | Inspektor stomatolog | 11 000 | 2% | | 25 000 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 10 | Shef reparti/laboratori në higjienë,<br>Shef reparti/laboratori në epidemiologji | 11 000 | 2% | | 25 000 | 9 000 | Nga…deri…lekë |
| 11 | Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor | 11 000 | 2% | | 25 000 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 12 | Mjek,<br>Stomatolog,<br>Inxhinier elektrik,<br>Kimist,<br>Veteriner,<br>Mikrobiolog | 11 000 | 2% | | 23 800 | | Nga…deri…lekë |
| 13 | Mjek Ftizioterapevt,<br>Mjek kirurg,<br>Mjek ortoped,<br>Mjek pneumoftiziatër | 11 000 | 2% | | 23 800 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 14 | Mjek radiolog,<br>Mjek hematolog,<br>Mjek onkolog | 11 000 | 2% | | 23 800 | 1 600 | Nga…deri…lekë |
| 15 | Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në | 11 000 | 2% | | 23 800 | 5 000 | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | shërbimet e shëndetit mendor | | | | | | |
| 16 | Përgjegjës zyre, Revizor, Inspektor | 11000 | 2% | | 23 800 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 17 | Specialist me arsim të lartë | 11 000 | 2% | | 23 500 | | Nga…deri…lekë |
| 18 | Specialist i lartë promocioni | 11 000 | 2% | | 23 000 | 4 000 | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES SË ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 58 300 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Shef shërbimi në anatomopatologji | 11 000 | 2% | | 38 500 | 3 500 | Nga…deri…lekë |
| 3 | Zëvendësdrejtor, Shef shërbimi | 11000 | 2% | | 30 000 | | Nga…deri…lekë |
| 4 | Shef shërbimi reanimacioni, Shef shërbimi infektiv, Shef shërbimi obsetrik gjinekologjik, Shef shërbimi kirurgji, Shef shërbimi ortopedi | 11 000 | 2% | | 30 000 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 5 | Shef shërbimi radiologji, Shef shërbimi neuropsikiatri | 11 000 | 2% | | 30 000 | 1 600 | Nga…deri…lekë |
| 6 | Shef shërbimi psikiatri | 11 000 | 2% | | 30 000 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 7 | Shef reparti/klinike, Përgjegjës/shef kabineti, Përgjegjës/shef laboratori/poliklinike/fizioterapi | 11 000 | 2% | | 25 000 | | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Shef i bankës së gjakut,<br>Shef reparti radiologjie,<br>Shef reparti pneumftiziatri | 11 000 | 2% | | 25 000 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 9 | Shef reparti/klinike psikatri | 11 000 | 2% | | 25 000 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 10 | Përgjegjës laboratori klinik biokimik | 11 000 | 2% | | 25 000 | 2 500 | Nga…deri…lekë |
| 11 | Përgjegjës/shef reparti anatopatologji | 11 000 | 2% | | 25 000 | 3 700 | Nga…deri…lekë |
| 12 | Mjek,<br>Stomatolog,<br>Biolog,<br>Kimist,<br>Fizikant,<br>Shef sektori,<br>Përgjegjës zyre,<br>Inxhinier biomedical | 11 000 | 2% | | 23 800 | | Nga…deri…lekë |
| 13 | Mjek infeksionist,<br>Mjek urgjence,<br>Mjek laboratori,<br>Kimist, fizikant laboratori,<br>Kimist në shërbimin e gjakut | 11 000 | 2% | | 23 800 | 600 | Nga…deri…lekë |
| 14 | Mjek onkolog,<br>Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale),<br>Mjek hematolog,<br>Mjek i bankës së gjakut,<br>Mjek obsetër gjinekolog,<br>Mjek pneumoftiziatër,<br>Mjek fizioterapeut | 11 000 | 2% | | 23 800 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 15 | Mjek radiolog | 11 000 | 2% | | 23 800 | 1 600 | Nga…deri…lekë |
| 16 | Mjek higjienist,<br>Farmacist | 11 000 | 2% | | 23 800 | 2 500 | Nga…deri…lekë |
| 17 | Mjek anatomopatolog,<br>Mjek anestezist reanimator, | 11 000 | 2% | | 23 800 | 3 700 | Nga…deri…lekë |
| 18 | Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në psikiatri | 11 000 | 2% | | 23 800 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 19 | Specialist i lartë | 11000 | 2% | | 21 000 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.4)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 68 500 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Zëvendësdrejtor | 11 000 | 2% | | 58 300 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 51 500 | | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 39 000 | | Nga…deri…lekë |
| 5 | Farmacist,<br>Analist | 11 000 | 2% | | 39 000 | 4 000 | Nga…deri…lekë |
| 6 | Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik | 11 000 | 2% | | 39 000 | 5 000 | Nga…deri…lekë |
| 7 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 23 800 | | |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 41 000 | 2 200 | Nga…deri…lekë |
| 2 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 30 000 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Mjek, stomatolog | 11 000 | 2% | | 25 000 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.6)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E INXHINIERISË BIOMJEKËSORE

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 38 500 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Shef sektori,<br>Përgjegjës i zyrës teknike,<br>Përgjegjës reparti | 11 000 | 2% | | 23 500 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 21 000 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.7)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 58 300 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Zëvendësdrejtor | 11 000 | 2% | | 30 000 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Përgjegjës i sektorit të laboratorëve,<br>Shef i bakës së gjakut | 11 000 | 2% | | 25 000 | 2 500 | Nga…deri…lekë |
| 4 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 25 000 | | Nga…deri…lekë |
| 5 | Mjek, kimist | 11 000 | 2% | | 25 000 | 1 100 | Nga…deri…lekë |
| 6 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 23 500 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.8)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË NJËSINË E TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTERË

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Shef i njësisë | 11 000 | 2% | | 70 000 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Kryepilot | 11 000 | 2% | | 70 000 | 8 000 | Nga…deri…lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Pilot | 11 000 | 2% | | 65 000 | 8 000 | Nga…deri…lekë |
| 4 | Teknik helikopteri | 11 000 | 2% | | 62 000 | | Nga…deri…lekë |
| 5 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 30 000 | | Nga…deri…lekë |
| 6 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 23 800 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR. 1 (KREU 1.9)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 11 000 | 2% | | 86 500 | | Nga…deri…lekë |
| 2 | Shef sektori | 11 000 | 2% | | 51 500 | | Nga…deri…lekë |
| 3 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 39 000 | | Nga…deri…lekë |

LIDHJA NR.2

| **POZICIONI** | **KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR** | **SHTESA (LEKË/MUAJ)** |
|---|---|---|
| Titullar i institucionit | Profesor | 30 000 |
| | Profesor i asociuar | 25 000 |
| Zëvendëstitullar i institucionit Shef shërbimi, shef klinike, reparti | Doktor i shkencave | 20 000 |
| | Doktor i shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimiore) | 25 000 |
| Përgjegjës sektori Mjek dhe specialist me arsim të lartë | Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata | 10 000 |
| | Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë (diplomuar në vendet perëndimore) | 20 000 |

**Shënim**. Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse, në universitetet apo shkollat e larta të

vendeve të përcaktuara në listën bashkëlidhur udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

**VENDIM**
**Nr.1020, datë 2.7.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 (krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 e 1.8), e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në paragrafin e parë, të pikës 8, vlera "...50 lekë... " zëvendësohet me "...120 lekë...".

2. Efektet financiare për vitin 2008, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të planifikuara për rritjen e pagave për këtë vit.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1 (KREU 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSETRIK GJINEKOLOGJIK TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË "SHEFQET NDROQI" TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune** | **Totali** |

| | | | | | | (SHPK) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Shef i sektorit të kujdesjeve infermierore | | 2% | 0 | 23 500 | 3 600 | Nga..deri ...lekë |
| 2 | Kryeinfermier shërbimi psikiatrik | | 2% | 0 | 23 500 | 6 000 | Nga..deri ...lekë |
| 3 | Kryelaborant në shërbimin e anatomisë patologjike,<br>Kryeinfermier shërbimi i terapisë intensive,<br>Kryeinfermiere shërbimi onkologjik,<br>Kryelaborant rrezatim kobalti,<br>Kryelaborant në histopatologji,<br>Kryeinfermierë të repartit të rezatimit | | 2% | 0 | 23 500 | 3 400 | Nga..deri ...lekë |
| 4 | Kryeinfermier reparti psikiatrik | | 2% | 0 | 23 500 | 5 000 | Nga..deri ...lekë |
| 5 | Kryeinfermier shërbimi neurokirurgji,<br>Kryemami e përgjithshme,<br>Kryeinfermier/kryemami reparti i terapisë intensive | | 2% | 0 | 23 500 | 2 600 | Nga..deri ...lekë |
| 6 | Kryeinfermierë kimioterapi,<br>Kryelaborant klinik biokimik,<br>Kryeinfermier në urgjencën e sëmundjeve të brendshme,<br>Kryeinfermier/mami salle,<br>Kryeinfermier/mami e dhomës së zgjimit,<br>Infermierë në hemodinamikë,<br>Kryelaborant imunolog, bakteriolog | | 2% | 0 | 23 500 | 1 800 | Nga..deri ...lekë |
| 7 | Kryeinfermier shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastik, kardiokirurgji, maksil ofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik),<br>Kryeinfermier/kryemami në repartin e kirurgjisë,<br>Kryemami truni në kirurgji,<br>Kryemami turni në obsetrikë,<br>Kryeinfermier reparti infektiv,<br><br>Kryeinfermier reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së | | 2% | 0 | 23 500 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | neurologjisë, neurokirurgji, onkologji), Kryeinfermier/kryemami sallë operacioni | | | | | | |
| 8 | Kryeinfermier shërbimi, Kryelaborant shërbimi, Kryemami shërbimi | | 2% | 0 | 23 500 | | Nga..deri ...lekë |
| 9 | Infermier/laborant në psikiatri | | 2% | 0 | 22 000 | 5 000 | Nga..deri ...lekë |
| 10 | Infermierë në kyriterapi, Laborant histopatolog | | 2% | 0 | 22 000 | 3 400 | Nga..deri ...lekë |
| 11 | Infermier/mami reanimacioni, neonatologji, Infermier në dhomën e zgjimit | | 2% | 0 | 22 000 | 2 650 | Nga..deri ...lekë |
| 12 | Infermier në kimioterapi | | 2% | 0 | 22 000 | 1 800 | Nga..deri ...lekë |
| 13 | Kryelaborant radiologjie | | 2% | 0 | 22 000 | 1 500 | Nga..deri ...lekë |
| 14 | Specialist i sektorit të kujdesjeve infermierore, Kryeinfermier i edukimit shëndetësor TB | | 2% | 0 | 22 000 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |
| 15 | Kryeinfermier në repartin e alergologjisë, Kryeinfermierë në sterilizim, Kryemami në izolim | | 2% | 0 | 22 000 | | Nga..deri ...lekë |
| 16 | Laborant radiolog në onkologji | | 2% | 0 | 20 500 | 3 700 | Nga..deri ...lekë |
| 17 | Laborant rrezatim kobalti | | 2% | 0 | 20 500 | 3 400 | Nga..deri ...lekë |
| 18 | Laborant në mjekësinë bërthamore | | 2% | 0 | 20 500 | 2 650 | Nga..deri ...lekë |
| 19 | Infermierë në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale, Infermier në sallën e operacionit | | 2% | 0 | 20 500 | 2 100 | Nga..deri ...lekë |
| 20 | Kryeinfermier reparti pranim urgjence, Laborant klinik biokimik, Infermier në punktin e gjakut, Infermier në hematologji, Infermier në onkologji, Infermier endoskopie, Infermier/laborant bakteriolog, imunolog | | 2% | 0 | 20 500 | 1 800 | Nga..deri ...lekë |
| 21 | Infermier reparti radiologjik, Laborant radiolog, Kryeinfermier (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) | | 2% | 0 | 20 500 | 1 500 | Nga..deri ...lekë |
| 22 | Infermier/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, | | 2% | 0 | 20 500 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike)<br>Instrumentarë | | | | | | |
| 23 | Kryeinfermier neonatologji,<br>Kryemami në qendrën e gruas,<br>Kryemami pranimi,<br>Kryeinfermier në kabinetin e dializës,<br>Kryemami/kryeinfermierrep arti,<br>Kryeinfermier konsultash në sëmundjet e brendshme,<br>Kryelaborant bakterolog, imunolog, ortopedi stomatologjike),<br>Infermierë sterilizimi | | 2% | 0 | 20 500 | | Nga..deri ...lekë |
| 24 | Infermier pavioni rrezatimi | | 2% | 0 | 19 500 | 3 310 | Nga..deri ...lekë |
| 25 | Infermier (infektiv, pranim urgjence, njësia e koordinimit të urgjencës) | | 2% | 0 | 19 500 | 1 800 | Nga..deri ...lekë |
| 26 | Ndihmësfarmacist,<br>Infermier në hemodializë | | 2% | 0 | 19 500 | 1 500 | Nga..deri ...lekë |
| 27 | Infermier fizioterapi | | 2% | 0 | 19 500 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |
| 28 | Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji),<br>Kryeinfermierë çerdhe për personelin,<br>Infermier,<br>Infermier çerdhe për personelin,<br>Kujdestar në pediatri | | 2% | 0 | 19 500 | | Nga..deri ...lekë |
| 29 | Kujdestar në psikiatri | | 2% | 0 | 17 000 | 5 000 | Nga..deri ...lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE, SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHPK)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Shef i sektorit të kujdesjeve infermierore | | 2% | 0 | 23 500 | | Nga..deri ...lekë |
| 2 | Specialist i sektorit të kujdesjeve infermierore, | | 2% | 0 | 22 000 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kryeinfermier i përgjithshëm | | | | | | |
| 3 | Ndihmësinspektor sanitar, ndihmëshigjienist, Ndihmësepidemiolog, Laborantë toksikologë | | 2% | 0 | 20 500 | 1 100 | |
| 4 | Infermier në shërbimet e shëndetit mendor | | 2% | 0 | 20 500 | 5 000 | |
| 5 | Infermier (hematologji, onkologji), Laborant rontgeni | | 2% | 0 | 20 500 | 1 500 | |
| 6 | Infermier statistike | | 2% | 0 | 20 000 | | |
| 7 | Infermier ortopedi, Infermier/laborant në fizioterapi | | 2% | 0 | 19 500 | 1 100 | |
| 8 | Kryeinfermier/kryemami Infermier në shërbimin stomatologjik, Laborant bakterolog/ klinik biokimik Ndihmësdentist | | 2% | 0 | 19 500 | | |
| 9 | Ndihmësbakterolog, Infermier/mami | | 2% | 0 | 17 000 | | |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË SPITALET E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE TIRANË

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHPK)** | **Totali** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike | | 2% | 0 | 23 500 | 6 000 | Nga..deri ...lekë |
| 2 | Kryeinfermier reparti në spitalet psikiatrike | | 2% | 0 | 23 500 | 5 000 | |
| 3 | Kryeinfermier i përgjithshëm | | 2% | 0 | 23 500 | 1 100 | |
| 4 | Laborant në anatominë patologjike | | 2% | 0 | 22 000 | 3 400 | |
| 5 | Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik bakterologjik, Kryeinfermier (kirurgji reanimacion, sallë | | 2% | 0 | 22 000 | 1 100 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | operacioni, obsetrikë gjinekologji) | | | | | | |
| 6 | Kryeinfermier | | 2% | 0 | 22 000 | | |
| 7 | Infermier në psikiatri, Laborant në psikiatri | | 2% | 0 | 20 500 | 5 000 | |
| 8 | Infermier reanimacioni, Ndihmësanestezistë, Ndihmësfarmacistë, Laborant radiologjie, Infermier në radiologji, Instrumentare, Infermier në hemodializë | | 2% | 0 | 19 500 | 1 500 | |
| 9 | Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit, Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatri, onkologji, dispanceri) Infermier në repartin e lindjes, Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji, Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji, Përgjegjës turni | | 2% | 0 | 19 500 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |
| 10 | Kryeinfermier në qendrën e sterilizimit, Infermier pranim urgjence, Laborant klinik biokimik/bakterologjik | | 2% | 0 | 19 500 | 600 | |
| 11 | Infermier | | 2% | 0 | 19 500 | | |
| 12 | Kujdestar në psikiatri | | 2% | 0 | 17 000 | 5 000 | |
| 13 | Kujdestar në pediatri, Ndihmës infermier | | 2% | 0 | 17 000 | | |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.4)

STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË LABORATORIN E KONTROLLIT TË BARNAVE

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHPK)** | **Totali** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Laborant | | 2% | 0 | 23 500 | | Nga..deri ...lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË KLINIKËN E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHPK)** | **Totali** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Kryeinfermier | | 2% | 0 | 23 500 | | Nga..deri ...lekë |
| 2 | Infermier Ndihmësstomatologë | | 2% | 0 | 19 500 | | Nga..deri ...lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.6)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa per vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHPK)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Kryeinfermier, Kryelaborant, | | 2% | 0 | 22 000 | | Nga..deri ...lekë |
| 2 | Infermier, Laborant | | 2% | 0 | 19 500 | 1 100 | Nga..deri ...lekë |

LIDHJA NR.1 (KREU 1.7)

Struktura e pagave për teknikët në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopterë

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **Emërtimi** | **Paga e** | **Shtesa** | **Shtesa për** | **Shtesa** | **Shtesa** | **Totali** |

| | | grupit (PG) | për vjetërsi (SHV) | kualifikim (SHK) | për pozicion (SHP) | për kushte pune (SHPK) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Teknik i përgjithshëm, Teknik elektrik | | 2% | 0 | 22 000 | | Nga..deri ...lekë |

LIDHJA NR.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

| GRUPI | | PAGA NË LEKË |
|---|---|---|
| 1 | Diplomë e shkollës së lartë | 10 000 |
| 2 | Diplomë e shkollës së mesme | 7 600 |
| 3 | Dëftesë lirimi (arsimi 8/9-vjeçar) dhe kurse infermierie | 6 000 |

PËRMBLEDHËSE PËR FONDIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Lidhja 1 | Emërtimi | Nr.i punonjësve | Fondi aktual i pagave | Fondi aktual i sigurimeve | Fondi gjithsej aktual paga e sigurime | Paga mesatare | Fondi i rritur i pagave | Fondi i rritur i sigurimeve | Fondi i rritur gjithsej | Efekti i rritjes në 000/lekë | Efekti i sig shoq në 000/lekë | Efekti gjithsej në 000/lekë | Rritja e fondit të Sh.P në % |
| | Kreu 1.1 | QSUT “Nënë Tereza” Tiranë, Spitali universitar Obsetrik-Gjinekologjik Tiranë; Spitali i sëmundjeve të Mushkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë; Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë | 1894 | 34313 | 7445.92 | 41758.92 | | 39065.2 | 8463.03 | 47528 | 4752 | 1017.11 | 5769.34 | 13.85 |
| | Kreu 1.2 | Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe, Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Autoriteti Shëndetësor Rajonal i Tranës | 960 | 15479.5 | 3359.05 | 18838.55 | | 17469.9 | 3790.97 | 21261 | 1990.40 | 431.92 | 2422.32 | 12.86 |
| | | Spitalet e Rretheve; Qendra e | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kreu 1.3 | Mirërritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve | 4471 | 53567.9 | 11624.23 | 65192.13 | | 70366.0 | 15269.42 | 85635 | 16798 | 3645.19 | 20443.29 | 31.36 |
| | Kreu 1.4 | Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave | 5 | 101 | 21.92 | 122.92 | | 113.5 | 24.63 | 138 | 12.50 | 2.71 | 15.21 | 12.38 |
| | Kreu 1.5 | Qendra e Shërbimeve Mjekësore | 9 | 140.92 | 30.58 | 171.50 | | 163.5 | 35.48 | 199 | 22.58 | 4.90 | 27.48 | 16.02 |
| | Kreu 1.6 | Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut | 26 | 426.16 | 92.48 | 518.64 | | 492.2 | 106.81 | 599 | 66.04 | 14.33 | 80.37 | 15.50 |
| | Kreu 1.7 | Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopterë | 5 | 94 | 20.40 | 114.40 | | 108.5 | 23.54 | 132 | 15 | 3.15 | 17.65 | 15.43 |
| | | Totali për të gjitha institucionet shëndetësore | 7370 | 104122.48 | 22594.58 | 126717.06 | | 127778.83 | 27713.88 | 155493 | 23656 | 5119.30 | 28775.651 | |
| | | Llogaritja e fondit të pagës së grupit | | | | | | | | | | | | |
| | | Nr i infermiere me arsimtë lartë | 800 | 9500 | | | | 10000 | | | | | | |
| | | Fondi | | 7600 | | | | 8000 | | | | | | |
| | | Nr. i infermiere me arsim të mesëm | 5780 | 7600 | | | | 7600 | | | | | | |
| | | Fondi | | 43928 | | | | 43928 | | | | | | |
| | | Infermiere me arsim 8-vjeçar&kurse infermierie | 790 | 6000 | | | | 6000 | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 7370 | 4740 | | | | 4740 | | | | | | |
| | | Fondi mujor i pagës së grupit | | 56268 | 12210.2 | | | 56668.00 | 12296.96 | | | | | |
| | | Fondi vjetor i pagës së grupit | | | | | | | | | | | | |
| | | Fondi total për infermiertë në një muaj | | 160390.48 | 34804.7 | 195195.21 | 21763 | 184446.83 | 40010.84 | 224457.67 | 24056.35 | 5206.10 | 29262.45 | |
| | | Paga mesatare | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | 15.00 | | 25027<br>15.00 | | | 29262.45 | |

Paga orare e llogaritur me P.mes/ me 174 orë 143.83
llogaritja e 25% 35.96
shtesa për punën në turnin e dytë=orët nga ora
19-22* pagën orare 107.87 afërsisht 120 l/ditë
të vendoset në tekstin e vendimit

**VENDIM**
**Nr.1022, datë 9.7.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.161, DATË 11.4.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 78 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.161, datë 11.4.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I "Krijimi dhe vendi", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, i pavarur. Organizimi dhe funksionimi i këtij instituti, që më poshtë do të quhet ISSH, rregullohen me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

b) Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 2

ISSH-ja është person juridik, shqiptar, me qendër në Tiranë, dhe përbëhet nga drejtoria qendrore, drejtoritë rajonale dhe agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore, që veprojnë në të gjithë vendin.".

2. Në kreun II "Fondet themelore, burimet e formimit dhe përdorimi i tyre", bëhen këto ndryshime:

a) Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 4

Fondi i ISSH-së administrohet në pesë degë të veçanta:

- Dega e sigurimit për sëmundje;
- Dega e sigurimit për barrëlindje;
- Dega e sigurimit për pensione;
- Dega e sigurimit për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;
- Dega e sigurimit të papunësisë.

Llogaria e sigurimeve shoqërore mbahet në Bankën e Shqipërisë, ndërsa llogaria e shpenzimeve administrative mbahet në llogari të veçantë.

Transferimet për pagesën e kontributeve e të shpenzimeve administrative lejohen vetëm me ligjin e buxhetit.".

b) Në fund të nenit 5 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"ISSH-ja krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave, që nevojiten për të përballuar, të paktën 3 muaj, shpenzimet për pensione.

Fondi rezervë mbahet në një llogari të veçantë.".

3. Në kreun III "Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore", bëhen këto ndryshime:

a) Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 6

Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore përfshin:

i) arkëtimin e detyrimeve, që rrjedhin nga derdhja e kontributit të punëmarrësve, punëdhënësve dhe të të vetëpunësuarve;

ii) pagimin e përfitimeve të sigurimeve, sipas dispozitave ligjore;

iii) investimin e fondit rezervë, me qëllimin rritjen e tij.”.

b) Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet drejtorive rajonale dhe agjencive lokale, kryen veprime për sigurimin shoqëror.

Drejtoritë rajonale caktojnë pensionet, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga personat e interesuar.

Përfitimet afatshkurtra për të punësuarit caktohen dhe paguhen nga punëdhënësit e tyre dhe, pas miratimit, rimbursohen nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Përfitimet afatshkurtra për të vetëpunësuarit dhe pensionet e të gjitha llojeve paguhen nga agjencitë paguese financiare, të specializuara, për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, sipas marrëveshjeve, që lidhen, ku përcaktohet edhe masa e komisionit.”.

4. Në kreun IV “Kontabiliteti dhe bilanci i ISSH-së”, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

ISSH-ja mban regjistrat dhe librat, në përputhje me ligjin për kontabilitetin, manualin kontabël, miratuar nga Ministria e Financave, si dhe rregulloren financiare, miratuar nga këshilli administrativ.”.

b) Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

ISSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton projektbuxhetin e vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga këshilli administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten, çdo vit, nëpërmjet Ministrit të Financave, Këshillit të Ministrave.”.

c) Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

1. Këshilli administrativ, pas miratimit të buxhetit, miraton ndarjen e buxhetit, sipas drejtorive rajonale.

2. Në përbërje të ISSH-së ngrihet njësia e auditimit të brendshëm, e cila auditon veprimtarinë e strukturave të saj jo më pak se një herë në dy vjet. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm emërohet/shkarkohet me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me miratimin e këshillit administrativ. Drejtuesi i njësisë raporton periodikisht dhe sipas kërkesave të këshillit.”.

5. Nenet 13, 21, 24, paragrafi i fundit, 25 e 26, të kreut V, shfuqizohen.

6. Neni 28 i kreut “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 28

ISSH-ja ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore.

Marrëveshjet me karakter ekonomik, para nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm, si përfaqësues i ISSH-së, i paraqiten, paraprakisht, këshillit administrativ, për miratim.

Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore, vetëm pas miratimit të këshillit administrativ.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1025, datë 9.7.2008**

**PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PËR TË CILAT ZOTËROHEN DOKUMENTE TË LIGJSHME PRONËSIE, POR QË NUK KANË TË PËRCAKTUAR SIPËRFAQEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 23, 24, shkronja “b”, e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Individët, familjet, personat juridikë, privatë ose shtetërorë, që zotërojnë dokumente, me të cilat provojnë pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme dhe kufijtë e saj, por nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen e pasurisë, për regjistrimin e saj, ku për zonën kadastrale, në të cilën ndodhet pasuria, nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive, duhet t’i paraqesin regjistruesit, një kërkesë për regjistrim fillestar pronësie.

2. Pasuritë e paluajtshme, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen, të cilat ndodhen në zona kadastrale, për të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, është duke u zhvilluar regjistrimi sistematik i pasurive, nuk mund të regjistrohen në një kartelë dhe hartë treguese regjistrimi, në emër të pronarit, pa u zhvilluar më parë procedura e regjistrimit të tyre, e përcaktuar në këtë vendim.

3. Për pasuritë e paluajtshme, që nuk e kanë të përcaktuar sipërfaqen në dokumentet ligjore të pronësisë dhe as sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim, të cilat ndodhen në zona kadastrale, për të cilat regjistrimi sistematik i pasurive do të përfundojë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, regjistrimi në një kartelë dhe hartë treguese regjistrimi, në emër të pronarit, do të bëhet vetëm pasi të zhvillohet procedura e regjistrimit, e përcaktuar në këtë vendim.

4. Pasuritë e paluajtshme, për të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk rezulton të jetë marrë vendim nga regjistruesi për përcaktimin e sipërfaqes, sipas shkronjës “b”, të nenit 24 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, edhe pse janë paraqitur deklaratat noteriale të pronarëve të pasurive kufitare, kur këto pasuri ndodhen të pozicionuara, gjeografikisht, në zona kadastrale, për të cilat ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive, sipas neneve 23-27 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, gjatë të cilit, sipërfaqja dhe pozicioni gjeografik i tyre është përcaktuar nga matjet në terren dhe pasuritë janë regjistruar në një kartelë dhe hartë treguese regjistrimi në emër të pronarit, do të vlerësohen se e kanë të përcaktuar sipërfaqen, pa qenë e nevojshme të zhvillohet procedurë regjistrimi fillestar, sipas shkronjës “b” të nenit 24 të ligjit të sipërpërmendur, me kusht, që gjatë periudhës së afishimit publik, të mos ketë asnjë pretendim të pazgjidhur për pozicionimin e pasurisë, kufijtë dhe sipërfaqen.

5. Pronësinë dhe kufijtë e pasurisë së paluajtshme, që kërkon të regjistrojë, kërkuesi, duhet ta provojë me dokumentet e pronësisë në kuptim të nenit 193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

6. Çdo subjekt, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i cili zotëron aktin e fitimit të pronësisë, sipas përcaktimit në nenin 193 të Kodit Civil, për pasuri, të cilat nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen, për pozicion gjeografik dhe sipërfaqja e tyre është përcaktuar gjatë regjistrimit sistematik

të pasurive të zonës kadastrale, ku ndodhet kjo pasuri, për regjistrimin e pasurisë në pronësi të tij, kur gjatë regjistrimit fillestar, pasuria është regjistruar me pronar “të pavërtetuar”, duhet të paraqesë në zyrën e regjistrimit, edhe këto dokumente:

a) aktin e fitimit të pronësisë;

b) një planvendosje apo genplan të pasurisë;

c) deklaratat noteriale të pronarëve të pasurive kufitare.

7. Kërkesa për regjistrim fillestar pronësie, sipas shkronjës “b” të nenit 24 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, në rastin kur kërkuesi zotëron dokumente pronësie për truallin ose për truallin dhe objektin mbi këtë truall, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin (aktin e fitimit të pronësisë), sipas nenit 193 të Kodit Civil, të regjistruar ose të paregjistruar në regjistrin hipotekor;

b) Deklaratat noteriale të pronarëve të pasurive kufitare, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për pronësinë dhe kufijtë e pasurisë, që pretendohet nga kërkuesi;

c) Planvendosjen/genplanin e pasurisë (i njëjtë me atë, që i bashkëlidhet deklaratave noteriale apo konfirmimeve të entit shtetëror);

ç) Dokumentacionin nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë, që pretendohet;

d) Mandatpagesën e shpenzimeve të regjistrimit (tarifa, taksa, shpenzime të tjera, nëse ka të tilla).

8. Kur në kufi të pronës, për të cilën është paraqitur kërkesë regjistrimi, janë prona shtetërore, si rrugë, rrugica, sheshe publike, lulishte, ndërtesa publike etj., deklarata noteriale zëvendësohet nga konfirmimi zyrtar, i dhënë nga bashkia/njësia bashkiake apo komuna përkatëse, e cila është pronare apo administron pronën shtetërore, pavarësisht faktit nëse bashkia apo komuna është e regjistruar si pronare apo administratore e pasurisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Në rastin kur pasuritë publike, kufitare me pasurinë për të cilën është paraqitur kërkesë për regjistrim, janë të regjistruara në zyrën e regjistrimit, në emër të një enti tjetër shtetëror, të ndryshëm nga bashkia apo komuna, konfirmimi duhet të bëhet nga titullari apo personi i autorizuar nga ky ent.

9. Kur në kufi të pronës janë prona të individëve, persona, fizikë apo juridikë, privatë a shtetërorë, të cilët nuk e kanë të regjistruar pasurinë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, deklarata noteriale e pronarit të pronës kufitare do të zëvendësohet nga një deklaratë noteriale, e bërë nga këta persona, në cilësinë e poseduesit të pasurisë kufitare. Në këtë rast, përveç deklaratës noteriale të poseduesit të pasurisë kufitare, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme më poshtë (ZRPP) procedon edhe me shpalljen e genplanit apo të planvendosjes së pasurisë, sipas procedurës së parashikuar në pikën 10 të këtij vendimi.

10. Kur deklarata e pronarëve kufitarë të pasurisë, për të cilën kërkohet regjistrimi, sipas shkronjës “b” të nenit 24 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, për arsye të ndryshme, objektive, me përjashtim të pretendimeve për kufirin e pasurisë, nuk është bërë e mundur të sigurohet, ZRPP-ja, afishon për publikun genplanin apo planvendosjen e pasurisë, për një periudhë prej 45 ditësh, në mjedise të dukshme të ZRPP-së dhe:

a) të njësisë bashkiake, në territorin e së cilës ndodhet pasuria;

b) në territorin ku ndodhet pasuria, për të cilën është bërë kërkesa për regjistrim.

Për zhvillimin e procedurës së afishimit është e nevojshme, që kufiri i pasurisë, për të cilin mungon deklarata e pronarit kufitar, të përputhet me kufirin, që tregojnë dokumentet hartografike, të marra nga arkivi teknik i ndërtimit. Në rast se ky kufi nuk përputhet, nuk zhvillohet procedura e afishimit dhe nga regjistruesi refuzohet regjistrimi.

11. Kërkuesi nënshkruan një deklaratë pranë ZRPP-së, me të cilën vërteton, në përgjegjësinë e vet, se nuk ka mundur, për arsye objektive, të sigurojë deklaratën noteriale të pronarit apo të pronarëve kufitarë me pasurinë, që kërkon të regjistrojë, si dhe natyrën e pamundësisë objektive. Në rast se pronari kufitar, brenda afatit prej 45 ditësh, paraqet në ZRPP ankesë apo pretendim të argumentuar e të mbështetur në dokumente ligjore për kufijtë e pasurisë, për të cilën kërkohet të bëhet regjistrimi, regjistruesi refuzon regjistrimin.

Në rast se nga pronari kufitar nuk paraqitet në ZRPP, brenda afatit prej 45 ditësh, ankesë apo pretendim për kufijtë e pasurisë, për të cilën kërkohet të bëhet regjistrimi, regjistruesi, brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të mësipërm, harton, në dy kopje, një procesverbal, i cili përmban një përshkrim të procedurave të kryera. Një kopje e procesverbalit depozitohet në arkivin e ZRPP-së,

ndërsa kopja tjetër administrohet në dosjen e kërkuesit të regjistrimit të pronës.

12. Kur pronën kufitare e kanë në pronësi dy a më shumë bashkëpronarë, kërkuesi paraqet deklaratat noteriale të bashkëpronarëve, për të cilët është e mundur marrja e kësaj deklarate. Për bashkëpronarët e tjerë, për të cilët nuk është e mundur objektivisht marrja e deklaratës noteriale, zbatohen procedurat e përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi.

13. Në rast se kërkuesi zotëron dokumente pronësie, të përcaktuara në nenin 193 të Kodit Civil, vetëm për objektin (ndërtesë), i cili nuk e ka të përcaktuar sipërfaqen, regjistruesi procedon me regjistrimin vetëm të objektit, pavarësisht se kufijtë e përmendur në dokumentin e pronësisë së objektit mund t'i referohen sipërfaqes, mbi të cilën është ndërtuar ky objekt. Në këtë rast, kërkesës për regjistrim fillestar të objektit, kërkuesi duhet t'i bashkëlidhë:

a) planvendosjen/genplanin e truallit, mbi të cilin ndodhet objekti, sipas kufizimeve, që tregon dokumenti i pronësisë;

b) planvendosjen/genplanin, i cili tregon pozicionin gjeografik të pasurisë, (objektin), për të cilën është paraqitur kërkesa;

c) deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë.

Kur për arsye objektive, kërkuesi nuk ka mundur të sigurojë deklaratat e pronarëve kufitarë, ndiqet procedura e parashikuar në pikën 10 të këtij vendimi.

14. Regjistruesi, nëse e gjykon të nevojshme, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, verifikon vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi. Për këtë qëllim, ai ka të drejtë të kërkojë dokumente nga të tretët, persona, fizikë ose juridikë, zyrat e noterisë dhe organe të administratës. Përveç verifikimit të vërtetësisë së dokumentacionit, nëse e gjykon të nevojshme, regjistruesi mund të urdhërojë verifikimin në terren të pasurisë, me një grup të përbërë nga të paktën 2 punonjës hartografë të zyrës së regjistrimit, për të bërë matjet dhe për të hartuar dokumentet përkatëse (planvendosje/genplan/planrilevimi).

15. Brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës, me përjashtim të rasteve të afishimit të parashikuara në pikën 10 të këtij vendimi, regjistruesi merr vendim për regjistrimin ose refuzimin e regjistrimit të pasurisë.

16. Regjistruesi, në dhënien e vendimit për regjistrim ose refuzim regjistrimi, mbështetet në:

a) dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi;

b) verifikimet e kryera prej tij, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, dhe të pikës 7 të këtij vendimi.

17. Forma dhe përmbajtja e vendimeve, që merr regjistruesi për regjistrimin ose refuzimin e regjistrimit të pasurive, në përputhje me kërkesat e shkronjës "b" të nenit 24 të ligjit të sipërpërmendur, përcaktohen në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Procedurat e parashikuara në pikën 10 të këtij vendimi, zbatohen në çdo rast tjetër të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilin nevojiten deklaratat e pronarëve kufitarë.

19. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
*Adresa: Rr."Jordan Misja" Tiranë, Tel +355/4/2337 13 Fax+355/4/234 419*

**VENDIM**

**Nr.______, datë__________**

Sot, më datë ______, në bazë të nenit 24, shkronja ”b” të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, në cilësinë e regjistruesit të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme________, mora në shqyrtim kërkesën nr.___ prot, datë ___, që i përket subjektit

**Kërkues:**_____________________________________________________________
(Gjeneralitetet e subjektit kërkues, si dhe adresa e deklaruar)
**Me objekt**:________________________________________________,
Pasi shqyrtova kërkesën e subjektit, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të dorëzuara nga kërkuesi bashkëlidhur kërkesës së tij, ato të krijuara nga korrespondenca me institucione të tjera dhe pasi kreva veprimet e nevojshme procedurale
(si , matje në terren, konfirmim etj.),

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

në zbatim të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar,

VËREJ SE:

**I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA**

**(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron etj.)**

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**II. LIGJI I ZBATUESHËM**

(Citoni në mënyrë taksative dispozitat e akteve ligjore e nënligjore ku do të mbështeteni për të dhënë vendimin duke shkruar të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.)

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE**

(Paraqisni të gjitha argumentet dhe arsyetimin tuaj në lidhje me mbështetjen ose jo në ligjin e zbatueshëm të fakteve të parashtruara me kërkesën e subjektit.)

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**IV. KONKLUZIONI**

(Paraqisni një konkluzion të shkurtër nëse e pranoni ose jo kërkesën, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, pas analizës ligjore të fakteve që keni bërë.)

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

**PËR KËTO ARSYE,**

Bazuar, në sa më sipër dhe në mbështetje të nenit 24, shkronja "b" të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, në cilësinë e regjistruesit të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme____,

VENDOSA:

(një nga rastet e mëposhtme)

1. Miratimin e plotë të kërkesës së subjektit ______, për regjistrim të pasurisë (përshkruani në mënyrë të plotë të dhënat e pasurisë);

2. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së subjektit ______, për regjistrim të pasurisë (përshkruani në mënyrë të plotë të dhënat e pasurisë);

3. Refuzimin e kërkesës së subjektit ______, për regjistrim të pasurisë (përshkruani në mënyrë të plotë të dhënat e pasurisë);

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

**REGJISTRUESI**

**VENDIM**
**Nr.1026, datë 9.7.2008**

**PËR CAKTIMIN E DIETËS DITORE TË USHTARAKËVE SHQIPTARË, TË DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK "EUFOR TCHAD/RCA", TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin "EUFOR Tchad/RCA", të Bashkimit Europian", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dieta ditore e ushtarakëve shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, në operacionin "EUFOR Tchad/RCA", të Bashkimit Europian, të jetë 60

(gjashtëdhjetë) euro/ditë qëndrimi në mision. Trajtimi financiar të fillojë nga data e dërgimit me mision.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 90 675 000 (nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.1027, datë 9.7.2008

### PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.412, DATË 15.9.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM, PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i pikës 1 të vendimit nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.1028, datë 9.7.2008

### PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA DISHNICË, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Dishnicë, të qarkut të Gjirokastrës, që do t'i transferohen në pronësi këtaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 3 (tri) fletë, që përfundon me numrin rendor 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi

dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dishnicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**FORMULARI PERFUNDIMTAR PER TRANSFERIMIN E E PRONAVE TE PALUAJTSHEME SHTETRORE**
**(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te vecanta te tipit Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj.)**

Institucioni i Pushtetit Qendror: **MMPAU**

Komuna: **DESHNICE**

| Nr | Numri I inventarit sipas DSHP | Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe Kullosore (EPK)shtrirja gjeografike e EPK | Emertesa e Ngastres Vendndodhja(sipas emerteses popullore | Numri ngastres | Destinacioni | Sip.Ha | Funksioni per te cilen perdoret prona | Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni/ Enti perdorues Statusi juridik i perdoruesit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 44 | EK Trebeshine | Gropat | 2 | Kullote | 95 | Kullote | MMPAU | Komuna | |
| 2 | 49 | " | Brinja | 1 | Kullote | 170 | Kullote | " | " | |
| 3 | 50 | " | Gjolle Brinje | 3 | Kullote | 66 | Kullote | " | " | |
| 4 | 51 | " | Brinja mbi Gjolle | 4 | Kullote | 159 | Kullote | " | " | |
| 5 | 52 | " | Frasher Kelcyre | 6 | Kullote | 69 | Kullote | " | " | |
| 6 | 53 | " | Kanerove | 30 | Kullote | 17 | Kullote | " | " | |
| 7 | 54 | " | Bovec | 31 | Kullote | 50 | Kullote | " | " | |
| 8 | 55 | " | Shqope Frashnje | 32 | Kullote | 16 | Kullote | " | " | |
| 9 | 63 | EK Leskovec-Pacomit | Ripa Kuqar | 4 | Kullote | 66 | Kullote | " | " | |
| 10 | 64 | " | Kasolle Shtike | 5 | Kullote | 29 | Kullote | " | " | |
| 11 | 65 | " | Vila Riban | 6 | Kullote | 29 | Kullote | " | " | |
| 12 | 66 | " | Perroi I Thelle | 7 | Kullote | 61 | Kullote | " | " | |
| 13 | 67 | " | Panarit | 8 | Kullote | 27 | Kullote | " | " | |
| 14 | 68 | " | Perroi I Veres | 9 | Kullote | 131 | Kullote | " | " | |
| 15 | 69 | " | Burrimi I Vasos | 12 | Kullote | 54 | Kullote | " | " | |
| 16 | 70 | " | Maja Shendelli | 13 | Kullote | 81 | Kullote | " | " | |
| 17 | 71 | " | Bregu I Gjineshit | 14 | Kullote | 45 | Kullote | " | " | |
| 18 | 72 | " | Benje Mertin | 15 | Kullote | 31 | Kullote | " | " | |
| 19 | 73 | " | Gjergac | 16 | Kullote | 25 | Kullote | " | " | |
| 20 | 74 | " | Rumneja | 17 | Kullote | 58 | Kullote | " | " | |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 75 | " | Lerez | 18 | Kullote | 79 | Kullote | " | " | |
| 22 | 76 | " | Prila | 19 | Kullote | 61 | Kullote | " | " | |
| 23 | 77 | " | Gjymlyshe | 20 | Kullote | 64 | Kullote | " | " | |
| 24 | 78 | " | Vitan Sheshez | 21 | Kullote | 39 | Kullote | " | " | |
| 25 | 79 | " | Senican Sen | 22 | Kullote | 32 | Kullote | " | " | |
| 26 | 198 | EP Deshnice | Droget(Arni) | 2a | Prodhues | 5 | Lp+Drzj | " | " | |
| 27 | 199 | " | Arnije e Droget | 2b | T.buke | 3 | | " | " | |
| 28 | 207 | " | Kodra e Xhezurit | 18 | Prodhues | 9 | Dru zjari | " | " | |
| 29 | 211 | " | Perroi I Lajthise | 22 | Prodhues | 17,5 | Dru zjari | " | " | |
| 30 | 212 | " | Hija e Gjere | 23 | Prodhues | 41 | Dru zjari | " | " | |
| 31 | 218 | EP Leskovec-Pacomit | Gremi I madh Velcisht | 6 | Prodhues | 30 | Dru zjari | " | " | |
| 32 | 222 | " | Faqe Pernd.Bregu I Seitit | 11 | Prodhues | 39,4 | Dru zjari | " | " | |
| 33 | 225 | " | Pylli I Djegur | 13 | Prodhues | 38,65 | Dru zjari | " | " | |
| 34 | 226 | " | Balta e Ponicave Shpellez | 14 | Prodhues | 42,4 | Dru zjari | " | " | |
| 35 | 227 | " | Bregu I Mullirit | 15a | Prodhues | 4 | Lp+Drzj | " | " | |
| 36 | 228 | " | Bregu I Mullirit | 15b | S.boshe | 16 | | " | " | |
| 37 | 234 | " | Gropa e Gjon Shpatit | 21a | Prodhues | 16,8 | Dru zjari | " | " | |
| 38 | 235 | " | Gropa e Gjon Shpatit | 21b | Prodhues | 10,8 | Dru zjari | " | " | |
| 39 | 236 | " | Gropat e Germit | 22 | Prodhues | 22,8 | Dru zjari | " | " | |
| 40 | 239 | " | Ara e Barjamit | 25 | Prodhues | 25,04 | Dru zjari | " | " | |
| 41 | 242 | " | Ilqe | 28 | Prodhues | 20 | Dru zjari | " | " | |
| 42 | 243 | " | Gura e Osmanit | 29 | Prodhues | 14,5 | Dru zjari | " | " | |
| 43 | 246 | " | Faqja e arzes | 32 | Prodhues | 14,8 | Dru zjari | " | " | |
| 44 | 247 | " | Gropa e Shellirzes | 33 | Prodhues | 13,05 | Dru zjari | " | " | |
| 45 | 248 | " | Gropa e Pusit | 34 | Prodhues | 19,8 | Dru zjari | " | " | |
| 46 | 249 | " | Bregu I ujkut | 35 | Prodhues | 30,1 | Dru zjari | " | " | |
| 47 | 253 | " | Gropa e Shkembit | 44 | Prodhues | 19,19 | Dru zjari | " | " | |
| 48 | 254 | " | Gropa e Lugut | 45 | Prodhues | 12,75 | Dru zjari | " | " | |
| 49 | 255 | " | Shpelleza | 46 | Prodhues | 35,4 | Dru zjari | " | " | |
| 50 | 257 | " | Dushku I kuq Cepan | 48 | Prodhues | 14 | Lp+Drzj | " | " | |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 51 | 258 | " | Gropa e Ramos | 55 | Prodhues | 29,9 | Dru zjari | " | " | |
| 52 | 259 | " | Gropa e Spataroves | 56 | Prodhues | 20,45 | Dru zjari | " | " | |
| 53 | 260 | " | Misova | 57 | Prodhues | 14,7 | Dru zjari | " | " | |
| 54 | 262 | " | Shulleri I Leskovecit | 59 | Prodhues | 30,3 | Dru zjari | " | " | |
| 55 | 264 | " | Shulleri I Karaules | 65 | Prodhues | 24,25 | Dru zjari | " | " | |
| 56 | 265 | " | Gura e Mujes | 66 | Prodhues | 14,25 | Dru zjari | " | " | |
| 57 | 268 | " | Shulleri I Bregasit | 70 | Prodhues | 27,06 | Dru zjari | " | " | |
| 58 | 269 | " | Shulleri I Xhanajt | 71 | Prodhues | 16,5 | Dru zjari | " | " | |
| 59 | 270 | " | Shulleri I Xhanajt | 72 | Prodhues | 17,5 | Dru zjari | " | " | |
| 60 | 275 | " | Korria (Ara e Selmanit) | 77 | Prodhues | 52,7 | Lp+Drzj | " | " | |
| 61 | 279 | " | Shulleri Gerdas | 81 | Prodhues | 36,1 | Dru zjari | " | " | |
| 62 | 280 | " | Korria e Madhe | 82 | Prodhues | 34,85 | Lp+Drzj | " | " | |
| 63 | 281 | " | Faqja sheshit te vogel | 83 | Prodhues | 29,35 | Dru zjari | " | " | |
| 64 | 296 | " | korria e Kasos | 98 | Prodhues | 28,35 | Lp+Drzj | " | " | |
| 65 | 301 | " | Shulleri Senican | 103 | Prodhues | 43,35 | Dru zjari | " | " | |
| 66 | 302 | " | Shen Thanas | 104 | Prodhues | 56 | Lp+Drzj | " | " | |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Dishnicë Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 |
| 44 | Kullotë | Në pronësi |
| 49-55 | Kullotë | Në pronësi |
| 63-79 | Kullotë | Në pronësi |
| 198-199 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 207 | Pyll | Në pronësi |
| 211-212 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 218, 222 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 225-228 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 234-236 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 239 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 242-243 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 246-249 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 253-260 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 262 | Pyll | Në pronësi |
| 264-265 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 268-270 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 275 | Pyll | Në pronësi |
| 279-281 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 296 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 301-302 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| | | |

**VENDIM**
**Nr.1029, datë 9.7.2008**

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA GRUEMIRË, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gruemirë, të qarkut të Shkodrës, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 3 (tri) fletë, që përfundon me numrin rendor 98 (nëntëdhjetë e tetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gruemirë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## FORMULARI PERFUNDIMTAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHEME SHTETRORE
### (Sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit; Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj.)

Institucioni i Pushtetit Qendror:**MMPAU**

Komuna: **Gruemirë**

| Nr | Numri sipas innventarit te DSHP | Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe Kullosore (EPK)shtrirja gjeografike e EPK | Emertesa e ngastres Vendndodhja(sipas emerteses popullore | Numri ngastres | Destinacioni | Sip. ne Ha | Funksioni per te cilen perdoret prona | Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni/ Enti perdorues Statusi juridik i perdoruesit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 108 | Lugina e Rrjollit | Lugu i Qershise | 76a | P.Prodhues | 19,75 | Lëndë punimi | MMPAU | Komuna | Ne pronesi |
| 2 | 109 | " | Faqëja e Maranajt | 76b | P.Prodhues | 18,5 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 3 | 110 | " | Qershiza | 77a | P.Prodhues | 15,75 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 4 | 111 | " | Qershiza | 77b | P.Prodhues | 3,25 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 5 | 112 | " | Faqëja e qershizës | 77c | P.Prodhues | 16,5 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 6 | 113 | " | Faqëja e Qershizës | 79a | P.Prodhues | 7,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 7 | 114 | " | Faqëja e Qershizës | 79b | P.Prodhues | 16,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 8 | 115 | " | Faqeja e Qershizës | 79c | P.Prodhues | 20,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 9 | 116 | " | Faqëja e Maranajt | 80a | P.Prodhues | 19,75 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 10 | 117 | " | Faqëja e Maranajt | 80b | P.Prodhues | 25,5 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 11 | 118 | " | Gropa e Qershizës | 81b | P.Prodhues | 20,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 12 | 119 | " | Lugu i Agrit | 82a | P.Prodhues | 18,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 13 | 120 | " | Brtija e Gurres | 83a | P.Prodhues | 14,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 14 | 121 | " | Ribat | 84 | P.Prodhues | 45,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 15 | 122 | " | Kashnjeti i Çicit | 85a | P.Prodhues | 5 | P.Frutash | " | " | " |
| 16 | 123 | " | Ribat | 86a | P.Prodhues | 5,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 17 | 124 | " | Kashnjeti Molles | 86c | P.Prodhues | 2,5 | P.Frutash | " | " | " |
| 18 | 125 | " | Faqëja e Rrahit | 87a | Shkëmb | 18,25 | shkëmb | " | " | " |
| 19 | 126 | " | Faqëja e Rrahit | 87b | P.Prodhues | 14,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 20 | 127 | " | Kopshti i Madh | 87c | P.Prodhues | 4,25 | P.Frutash | " | " | " |
| 21 | 128 | " | Shpati i Shkallës | 88a | Shkëmb | 14 | shkëmb | " | " | " |
| 22 | 129 | " | Shpati i Shkallës | 88b | P.Prodhues | 11 | dru zjarri | " | " | " |
| 23 | 130 | " | Bishkazi i madh | 88c | P.Prodhues | 6,5 | P.Frutash | " | " | " |
| 24 | 131 | " | Fusha e Kashnjetit | 89b | P.Prodhues | 25,22 | P.Frutash | " | " | " |
| 25 | 132 | " | Kashnjeti i Egçit | 90 | P.Prodhues | 17,5 | P.Frutash | " | " | " |
| 26 | 133 | " | Kashnjeti i Lepuroshit | 91 | P.Prodhues | 20 | P.Frutash | " | " | " |
| 27 | 134 | " | Fusha e Miletit | 92a | P.Prodhues | 17 | dru zjarri | " | " | " |
| 28 | 135 | " | Fusha e Miletit | 93a | P.Prodhues | 11 | dru zjarri | " | " | " |
| 29 | 136 | " | Fusha e Miletit | 94 | P.Prodhues | 63 | dru zjarri | " | " | " |
| 30 | 137 | " | Fusha e Miletit | 95a | P.Prodhues | 20,5 | dru zjarri | " | " | " |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | 138 | " | Kodra e Dëllinjës | 97a | sip.bosh | 5,75 | Kullotë | " | " | " |
| 32 | 139 | " | Shtegu i Logut | 97b | P.Prodhues | 26,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 33 | 140 | " | Kroi i keq | 97c | P.Prodhues | 11,25 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 34 | 141 | " | Kroi i Keq | 97d | Shkëmb | 4,25 | shkëmb | " | " | " |
| 35 | 142 | " | Fena e keqe | 98a | P.Prodhues | 7,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 36 | 143 | " | Fena e keqe | 98b | P.Prodhues | 12 | dru zjarri | " | " | " |
| 37 | 144 | " | Faqëja e Kroit Keq | 98c | P.Prodhues | 17,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 38 | 145 | " | Shpati i Kroit Keq | 98d | P.Prodhues | 8,5 | Lëndë punimi | " | " | " |
| 39 | 146 | " | Faqeja e Kroit Keq | 99a | P.Prodhues | 7,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 40 | 147 | " | Faqëja e Kroit Keq | 99b | P.Prodhues | 15,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 41 | 148 | " | Shpati i Kroit Keq | 99c | P.Prodhues | 15,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 42 | 149 | " | Mbi sheun e keq | 100b | P.Prodhues | 17,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 43 | 150 | " | Mbi sheun e keq | 100c | P.Prodhues | 11,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 44 | 151 | " | Mbi sheun e keq | 100d | P.Prodhues | 5,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 45 | 152 | " | Pylla e zeze | 101a | P.Prodhues | 27,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 46 | 153 | " | Pylla e zeze | 101b | P.Prodhues | 17,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 47 | 154 | " | Pylla e zeze | 101c | P.Prodhues | 7,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 48 | 155 | " | Lugu i Pyllit të zi | 102b | P.Prodhues | 11,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 49 | 156 | " | Faqja e Pyllës së Madhe | 102c | P.Prodhues | 17 | dru zjarri | " | " | " |
| 50 | 157 | " | Faqja e Pyllës së Madhe | 102d | P.Prodhues | 17,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 51 | 158 | " | Faqëja e Mendres | 103b | P.Prodhues | 23,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 52 | 159 | " | Faqëja e mendrës | 103c | P.Prodhues | 14,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 53 | 160 | " | Pylli i Vrakës | 105 | P.Mbrojtës | 22 | P.Frutash | " | " | " |
| 54 | 161 | Koplik Gruemirë | Shpati i Dukës | 59a | P.Mbrojtës | 32,5 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 55 | 162 | " | Shpati i Reçit | 59b | P.Mbrojtës | 31,25 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 56 | 163 | " | Rafshina e Dukës | 60a | P.Mbrojtës | 19,75 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 57 | 164 | " | Kolata e Dukës | 61a | P.Mbrojtës | 15,75 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 58 | 165 | " | Shullani i Dukës | 61c | Shkëmb | 21,5 | shkëmb | " | " | " |
| 59 | 166 | " | Kolata e Gropë Qenve | 62 | P.Mbrojtës | 36 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 60 | 167 | " | Vajushi | 63 | Kullot | 337,69 | Kullotë | " | " | " |
| 61 | 168 | " | Maja e reçit | 64 | P.Mbrojtës | 45,5 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 62 | 169 | " | Shpati i Kuçit | 65 | P.Mbrojtës | 48,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 63 | 170 | " | Maja e Egçit | 66 | P.Mbrojtës | 41,5 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 64 | 171 | " | Mali i Dragovojes | 67 | P.Mbrojtës | 36,37 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 65 | 172 | " | Vajushi | 69 | Shkëmb | 218,62 | shkëmb | " | " | " |
| 66 | 173 | " | Bushatet e Kçarit | 70a | P.Mbrojtës | 27,75 | Mbr.eruzioni | " | " | " |
| 67 | 174 | " | Gjormi | 70c | Shkëmb | 11 | shkëmb | " | " | " |
| 68 | 175 | " | Kçari | 71a | P.Mbrojtës | 23,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 69 | 176 | " | Gështenjat e Linajve | 71c | Shkëmb | 21 | shkëmb | " | " | " |

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 70 | 177 | " | Demirajt | 72 | Shkëmb | 234,45 | shkëmb | " | " | " |
| 71 | 178 | " | Brijat e gjormit | 73 | P.Mbrojtës | 61,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 72 | 179 | " | Gjormi | 74 | P.Mbrojtës | 53,25 | dru zjarri | " | " | " |
| 73 | 180 | " | Gjormi | 75 | P.Mbrojtës | 36,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 74 | 181 | " | Baliaj | 77 | P.Prodhues | 39 | dru zjarri | " | " | " |
| 75 | 182 | " | Baliaj | 78 | P.Prodhues | 46,75 | dru zjarri | " | " | " |
| 76 | 183 | " | Gruemir Çezme | 79 | P.Prodhues | 56,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 77 | 184 | " | Qafe Lopc | 80a | P.Prodhues | 32,5 | dru zjarri | " | " | " |
| 78 | 349 | "Rosek-Drisht" | Faqja e vogel | 2 | P.Prodhues | 41,50 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 79 | 350 | | Faqja e Murranit | 3c | P.Prodhues | 6,50 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 80 | 351 | " | Suka e Madhe | 3d | P.Prodhues | 4,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 81 | 352 | " | Rrethi i shesheve | 6 | P.Prodhues | 41,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 82 | 353 | " | Fratia | 7 | P.Prodhues | 35,10 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 83 | 354 | " | Brinja e Dragushes | 8a | P.Prodhues | 40,80 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 84 | 355 | " | Brinja e Dragushes | 8b | Inproduktive | 3,00 | - | " | " | " |
| 85 | 356 | " | Brija e kroit shkozes | 9a | P.Prodhues | 23,25 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 86 | 357 | " | Brinja e kronit | 9b | Inproduktive | 11,75 | - | " | " | " |
| 87 | 358 | " | Lugjet e bishes | 10a | P.Prodhues | 30,50 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 88 | 359 | " | Lugjet e bishes | 10b | P.Prodhues | 17,25 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 89 | 360 | " | Fushe-Kurtaj | 11a | P.Prodhues | 44,75 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 90 | 361 | " | Fushe-Kurtaj | 12 | P.Prodhues | 35,50 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 91 | 362 | " | Brinja e zhdrathit | 13a | P.Prodhues | 14,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 92 | 363 | " | Brinja e zhdrathit | 13b | Inproduktive | 11,00 | - | " | " | " |
| 93 | 364 | " | Buganja | 14a | P.Prodhues | 3,50 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 94 | 365 | " | Shpella e Frashnit | 14b | P.Prodhues | 13,25 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 95 | 366 | " | Prroi Maranajt | 15a | P.Prodhues | 10,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 96 | 367 | " | Prroi Maranajt | 15b | Inproduktive | 10,00 | - | " | " | " |
| 97 | 368 | " | Brinja e Maranajt | 16 | P.Prodhues | 45,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |
| 98 | 369 | " | Brinja e Maranajt | 17 | P.Prodhues | 25,00 | Per pr.l.drusore | " | " | " |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Gruemirë

Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 108-164 | Pyll e sipërfaqe të tjera | Në pronësi |
| 349-369 | | |
| | | |

**VENDIM**
**Nr.1030, datë 9.7.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.411, DATË 9.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË SARANDË, TË QARKUT TË VLORËS", DHE PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA SARANDË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.411, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre), e pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Sarandë të qarkut të Vlorës.
2. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që do t'i transferohen në pronësi të kësaj njësie.
3. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## 2.FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETRORE

**(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te veçanta te tipit pyje, kullota.Livadhe,shkembore etj)**

***Institucioni i Pushtetit Qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE,***

*Identifikoi:* ***Granit Shehu***

***Bashkia : Sarande***

*Supervizoi:* ***Zylfo Pasha***

*Kryetari I Bash* ***Edmond Gjoka***

***Fusha e perdorimit te prones: Pyje, Kullota etj.***

Drejtori i DSHP **Jani Babi**

| Nr. | Nr i INV | Emertesa e Ekonomise Pyjore/Kullosore | Emertesa e Ngastres Vendodhja (sipas emertimit popullore) | Nr. i ngastr | Destinacioni | Sip. ne ha | Funksini per te cilin perdoret prona | Institucioni Enti me Pergjegjesi Administrative | Institucioni Enti perdorues Statusi Juridik | Te dhena te tjera (shenime te vecanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 1 | 368 | Heremec | Lekurez | 19 | Kullote | 85 | Kullote | MMPAU | B.Sarande | |
| 2 | 369 | Heremec | Dardhe | 1 | Kullote | 172 | Kullote | MMPAU | B.Sarande | |
| 3 | 370 | Heremec | Dardhe | 2 | Kullote | 83 | Kullote | MMPAU | B.Sarande | |
| 4 | 371 | Heremec | Limjoni | 3 | Kullote | 60 | Kullote | MMPAU | B.Sarande | |
| 5 | 372 | Ek. Pyj. Bregdet | Faqja mbi marine | 131 | Pyll | 45,50 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 6 | 373 | Ek. Pyj. Bregdet | Mbi stadium | 132 | Pyll | 18,50 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 7 | 374 | Ek. Pyj. Bregdet | Mbi f.sportit | 133 | Pyll | 44,00 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 8 | 375 | Ek. Pyj. Bregdet | Mbi kamin | 134 | Pyll | 58,50 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 9 | 376 | Ek. Pyj. Bregdet | Cfaka | 135 | Pyll | 16,00 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 10 | 377 | Ek. Pyj. Bregdet | Hamalloi | 136 | Pyll | 40,00 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 11 | 378 | Ek. Pyj. Bregdet | Faqja lindore e qytetit | 137 | Pyll | 47,50 | Pyll | MMPAU | DSHP | |
| 12 | 379 | Ek. Pyj. Bregdet | Depo e ujit | 138 | Pyll | 27,50 | Urbane | MMPAU | B.Sarande | V.K.RR.T.R.SH Nr. 3, datë 19.02.1999 |
| 13 | 380 | Ek. Pyj. Bregdet | Faq, Lind. Lekursit | 139 | Pyll | 17,00 | Pyll | MMPAU | B.Sarande | |
| 14 | 381 | Ek. Pyj. Bregdet | Faq,Per. Lekursit | 140 | Pyll | 30,00 | Urbane | MMPAU | B.Sarande | |
| 15 | 382 | Ek. Pyj. Bregdet | Gurore | 141 | Pyll | 40,00 | Urbane | MMPAU | B.Sarande | |
| 16 | 383 | Ek. Pyj. Bregdet | Mbi Cuke | 142 | Pyll | 46,50 | Urbane | MMPAU | B.Sarande | |

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Sarandë Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 368-383 | Pyll, kullotë etj | Në pronësi |
| | | |

**VENDIM**
**Nr.1035, datë 9.7.2008**

**PËR CAKTIMIN E TARIFËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTEVE, NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, NË FUSHËN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për çmimet dhe tarifat", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e tarifës 1 (një) euro për pagesën e licencave, që u jepen, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, subjekteve, persona, fizikë dhe juridikë, privatë, për ushtrimin e veprimtarive:

A) në fushën e punimeve të ndërtimit, "Licencë profesionale për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh në zbatim";

B) në fushën e transportit rrugor:

i) licencë për transport ndërkombëtar udhëtimesh;

ii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus;

iii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të specializuar në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus, vajtje-ardhje.

C) në fushën e transportit detar:

i) leje për të vepruar në linja të rregullta ndërkombëtare detare;

ii) leje për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit dhe omerxhimit;

iii) leje për veprimtarinë e tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore, në zonën portuale të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse;

iv) leje për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1070, datë 23.7.2008**

## PËR MIRATIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE "PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE", NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIMIT TË SAGEM SECURITE DHE FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## KËRKESË

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave, shpall kërkesën për shpronësim publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Vermosh.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Ministria e Financave. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Financave.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Plotësim dokumentacioni", do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Financave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik"). Deri në këto momente paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

Për ato pasuri me pronar "Shtet", për të cilat është bërë shënimi "Pretendim pronësie", pronarët pretendentë duhet të paraqesin brenda afatit 15-ditor, dokumentacionin respektiv të pronësisë ose konfirmimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Malësi e Madhe, për të vërtetuar titullin e pronësisë, në të kundërt këto pasuri do të përjashtohen nga shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 632 345 (gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë.

| Nr. | Emër mbiemër | Njësia | Sasia | Çmimi mesatar (në lekë) | Vlera në lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjokë Mark Bunjaj | $m^2$ | 1 115 | 623 | 632 345 | |
| | Shuma gjithsej | $m^2$ | 1 115 | 623 | 632 345 | |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 25.7.2008
Doli nga shtypi më 25.7.2008

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë